

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Naim Kurtishi, me procesmbajtëse Drita Baftijari, në kontestin e paditëses M. Sh., nga Prizreni, kundër të paditurës Drejtoria Komunale për Arsim në Prizren, të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal, me objekt të padisë kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1149.44 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 25.07.2014, në të cilën ishin prezentë pala paditëse dhe i autorizuari i palës së paditur APK-Besim Morina, me datë 25.07.2014 merr këtë:

AKTGJYKIM

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditëses M. Sh., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit, që t'i paguaj paditëses në emër të pagave jubilarë për në pension dhe dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë totale prej 1149.44 euro, me kamatë që paguan banka për depozitim mbi një vit, si dhe ka kërkuar pagimin e shpenzimeve gjyqësore-taksës gjyqësore prej 20 euro, **si tërësisht e pa bazuar.**

II. Secila palë i bart shpenzimet veta.

Arsyetim

Paditësja M. Sh., si në padinë e parashtruar me datë 17.05.2012, ashtu edhe në shqyrtimin kryesor, ka kërkuar që gjykata të aprovoj kërkesëpadinë e paditëses dhe të detyrohet e paditura Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, që t'i paguaj paditëses, në emër të dy pagave jubilarë për në pension dhe dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë totale prej 1149.44 euro, me kamatë që paguan banka për depozitim mbi një vit, si dhe ka kërkuar pagimin e shpenzimeve gjyqësore-taksës gjyqësore prej 20 euro. Në fjalën përfundimtare paditësja ka deklaruar se kërkesëpadia ka mbështetje ligjore sepse shumë persona të tretë kanë realizuar këtë të drejtë, të cilët kanë qenë në pozitë të njëjtë me paditësen, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë.

Pala e paditur, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, në përgjigjen e dhënë me shkrim, pranë së cilës ka ngelur edhe në shqyrtimin kryesor, ka propozuar që padia e parashtruar të shpallet e pabazuar, me arsyetimin se Komuna e Prizrenit nuk ka legjitimacion pasiv që të jetë palë e paditur në rastin konkret, ngase Kontrata kolektive është nënshkruar nga Sindikata dhe Qeveria e Kosovës, e cila nuk është zbatuar për shkak të pamundësisë financiare, kjo kontratë do të duhej eventualisht të obligoj Qeverinë e Kosovës, si nënshkruese e saj, e jo komunat apo drejtoritë komunale, pasi që për t'i obliguar komunat ato do të duhej individualisht të nënshkruanin këtë kontratë. E paditura gjithashtu ka kërkuar nga gjykata që sipas detyrës zyrtare të shikoj afatin tre vjeçar të kontratës kolektive dhe mos përtëritjen e saj, apo mos zbatimin e saj në praktikë, andaj dhe propozon që kërkesëpadia të refuzohet.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar këto prova: ka bërë leximin e vendimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës në Prizren, me nr.177/11, të datës 21.02.2011, mbi shuarjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension të punëtores M. Sh., është bërë leximi i kërkesës së paditëses drejtuar Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës në Prizren, e datës 27.04.2011, është bërë leximi mbi refuzimin e kësaj kërkesëvendimi, është bërë leximi i vendimit të inspektoratit të punës, është bërë leximi i vendimit mbi vitet e shërbimit.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesa e paditëses është e pa bazuar.

Gjykata me leximin e vendimit e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës në Prizren me nr.177/11, të datës 21.02.2011, mbi shuarjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkuarjes në pension të punëtores M. Sh., ka vërtetuar faktin se paditëses M. Sh., me datë 25.02.2011, i është shuar marrëdhënia e punës nga ana e palës së paditur-Drejtorisë së Arsimit, pasi që paditësja me këtë datë ka mbushur 65 vjeç dhe ka plotësuar kushtet për pensionim.

Me leximin e kërkesës së shkruar me datë 27.04.2012, nga ana e paditëses, është konstatuar fakti se paditësja ka kërkuar nga e paditura pagesën e shpërblimit të dy pagave jubilarë për në pension dhe dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë të totale prej 1149.44 euro.

Me leximin e përgjigjes-refuzimit të kërkesës nga ana e Drejtorisë Komunale së Arsimit në Prizren, të datës 10.05.2012, me referencë 409/12, gjykata ka konstatuar faktin se kjo drejtori ka refuzuar kërkesën e paditëses M., për pagesën e shpërblimit të dy pagave jubilarë për në pension dhe dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë të totale prej 1126 euro.

Me leximin e vendimit të Inspektoratit të Punës, gjykata ka konstatuar faktin se edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Trupi ekzekutiv i inspektoratit të punës, ka refuzuar kërkesën e paditëses M. Sh., e parashtruar me ankesën e datës 07.06.2012, lidhur me shpërblimin jubilar .

Me leximin e vërtetimit të SHFMU “Motrat Qiriazit”, mbi vitet e shërbimit, me Nr. protokoll-it 66/12, i datës 17.05.2012, gjykata ka konstatuar faktin se paditësja M. Sh., ka punuar si arsimtare e biologjisë pranë kësaj shkolle prej datës 01.09.1972, deri me datë 25.02.2011, gjegjësisht ka punuar 38 vite e 5 muaj e 24 ditë.

Në bazë të gjendjes se vërtetuar faktike, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e pazuar dhe duhet të refuzohet. Këtë qëndrim gjykata e mori duke u bazuar në faktin se kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e dy pagave jubilarë për në pension dhe dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit shumë të totale prej 1149.44 euro, është në kundërshtim me dispozitat ligjore, respektivisht me dispozitat e kontratës kolektive, përkatësisht me afatshmërinë e saj, ku sipas nenit 44 të kësaj kontrate, kjo kontratë ka filluar të zbatohet me datë 01.01.2005 dhe zbatimi i saj ka vazhduar për tri vite, përkatësisht deri në vitin 2008, kur edhe ka skaduar afati i kësaj kontrate, e cila kontratë më nuk është vazhduar, andaj dhe e njëjta nuk mund të zbatohet pas këtij afati. Duke marrë parasysh faktin se paditësja ka dalë në pension në me datë 25.02.2011 dhe se padia e paditëses në këtë gjykatë është parashtruar me datë 17.05.2012, e në anën tjetër kontrata kolektive ka skaduar në vitin 2008, të ardhurat të cilat paditësja i ka kërkuar në kërkesëpadi nuk i takojnë bazuar në nenin 90 të Ligjit të Punës ku parashihen kushtet e marrëdhënieve kolektive.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor konform nenit 452.1 të LPK-së.

Nga të lartcekurat dhe bazuar në nenin 90 të Ligjit të punës, lidhur me nenin 143 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.476/12 me datë 25.07.2014

Gjyqtari
Naim Kurtishi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.